



**Prishtinë, 23 qershor 2016**  
**Kodi i ZRRE-së: V\_831\_2016**

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë nr.03/L-185;
- Neni 10 dhe shtojca 1 e Procedurës për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike;
- Kërkesën e KEDS-it të datës 23.05.2016 për përditësimin e shtojcës 1 së Procedurës për Identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike – Forma e re e procesverbalit e cila do të gjenerohet nga pajisja e dorës.

në mbledhjen e mbajtur më datë 23 qershor 2016 e nxori këtë

**VENDIM**

- I. APROVOHET** kërkesa e KEDS-it për plotësimin e shtojcës së Procedurës për Identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike me Formën e re të procesverbalit i cili do të gjenerohet nga pajisja e dorës.

**Arsyetim**

- Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 23.05.2016 ka pranuar nga KEDS-i kërkesën për plotësimin e shtojcës 1 të Procedurës për Identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike. Kërkesa e KEDS-it ka për qëllim që përpilimi i procesverbalit nga punëtorët e autorizuar të KEDS-it të bëhet përmes pajisjes së dorës (në mënyrë automatike). Forma e procesverbalit e cila do të gjenerohet nga pajisje e dorës do të përmbajë një formë standarde të të gjitha procesverbaleve të përdorura deri më tani nga punëtorët e KEDS-it, si: procesverbalin e inspektimit, procesverbalin e shkyçjes dhe rikyçjes, procesverbalin e ndërrimit të njehsorit elektrik, si dhe procesverbalin e lidhjeve të reja.
- ZRRE ka shqyrtuar kërkesën e KEDS-it për plotësimin e shtojcës 1 të procedurës së cekur më lartë dhe vlerëson se kjo formë e re e procesverbalit propozuar nga ana e KEDS-it e cila do të gjenerohet nga pajisja e dorës përmban procesverbalin e inspektimit, shkyçjes dhe rikyçjes, ndërrimit të njehsorit elektrik dhe se të gjitha këto aktivitete do të kenë një formë standarde të procesverbalit. Pra, përderisa KEDS-i deri më tani ka përdorur katër forma të ndryshme të procesverbaleve, tani Forma e re e procesverbalit do të unifikohet në një procesverbal të vetëm dhe e cila do të gjenerohet përmes pajisjes së dorës.
- ZRRE konstaton se forma e re e procesverbalit të inspektimit është në të mirë të konsumatorëve, pasi që do të minimizoj gabimet gjatë përpilimit të procesverbalit, informatat do të jenë vazhdimisht të përditësuara, si dhe në çdo kohë mund të verifikohet inspektimi i pikës matëse, pasi pajisja e dorës e ka edhe modulin e GPS, e cila mundëson një verifikim të tillë.

